



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 687 prot

Roskovec , më 30.01 .2026

VENDIM

Nr. 3 datë 29 / 01 /2026

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI 6% PËR BLOK-NDIHMËN PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji Nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Nenit 21 të Ligjit Nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 1, të Kreut IV të Vendimit Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- Miratimin e kriterëve të mëposhtëme për trajtimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, për vitin 2026.
- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brënda tre muajëve të fundit dhe nuk janë përzgjedhur fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familjet të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyra e ndihmës ekonomike.
- Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevojë , të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

- Familjet ku kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesën e paaftësisë.
 - Familjet me prindër të divorcuar me të paktën një fëmijë në arsimin bazë ose të lartë.
 - Familjet me kryefamiljar vajzat nëna dhe gratë e veja.
 - Familjet të cilat nuk kanë anëtar përfitues të pensionit të pleqërisë.
-
- Ngarkohet sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

